

Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Do të kemi raste të flasim në detaje për një plan më të integruar të menaxhimit dhe të trajtimit të mbetjeve, por po i përgjigjem në mënyrë më specifike pyetjes që ka të bëjë me menaxhimin e bregdetit dhe të pastrimit të kësaj pjese, pra sigurisht që në këtë mandat ne do ta kemi prioritet këtë gjë, siç e dëgjuat edhe në fjalën e Kryeministrit. Të gjithë e kemi shumë të qartë se bashkëjetesa e mjedisit dhe e turizmit nën të njëjtën kupolë me menaxhimin, siç është ministria në fjalë, shkojnë bashkë, me të mirën dhe me të keqen e tyre, sepse pa një mjedis të pastër nuk mund të kemi turizëm cilësor, aq më pak ekoturizëm, që sot është edhe aseti më i madh për zhvillimin e turizmit shqiptar, bashkë me atë bregdetar, ku praktikisht është dyndja më e madhe apo, le të themi, pika më e frekuentuar nga turistët, qoftë turistët vendës, qoftë ata të huaj.

Zonat bregdetare, me një gjatësi 420 kilometra, janë më produktivet për sa i përket larmisë së habitateve, shërbimeve, ekosistemeve, prodhimit të biznesit, shërbimit dhe zhvillimit urban, por, njëkohësisht, janë edhe zona me shumë paradokse, me mbipopullim intensiv brenda një njësie të shkurtër kohe, me një presion të madh për zhvillim, me presion të madh ndotjeje, me konflikte për përdorimin e tokës. Nuk ka asgjë të re në këtë që po them, por sigurisht që kjo kërkon një përgjigje të organizuar shumë mirë, ose më saktë një goditje. Në fakt është kjo maxhorancë, e cila tetë vjet më parë ka hedhur themelet e një vëmendjeje të dedikuar institucionale për vijën e bregdetit, duke krijuar një agjenci të përkushtuar për këtë, por jemi ende në mungesë të përgjigjes në lidhje me përkufizimin e saktë të hapësirës, që përfshihet në vijën bregdetare, e që praktikisht sot mbulohet nga njëmbëdhjetë bashki. Ka një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, të paktën gjashtëmbëdhjetë në listimin tim, por nuk gjejmë ende një kornizë rregullatore të posaçme për bregdetin. Për këtë arsye, një draftligj është në proces, dhe do të jetë prioritet i këtij mandati me objektiva shumë të qarta, në radhë të parë duke garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të zonës bregdetare, si dhe duke siguruar mbrojtjen e zhvillimit racional, për caktimin për herë të parë të kufijve të bregdetit e të brezit të zhvillimeve të qëndrueshme, dhënien e një statusi të veçantë juridik zonës bregdetare, përcaktimin e bregut të detit si pronë e patjetërsueshme, ndalimin e ndërtimeve në bregun e detit, si dhe disiplinimin e ndërtimeve në brezin e zhvillimeve të kontrolluara në harmoni me bregun e detit.

Në vijim, pjesë e programit tonë është edhe reformimi i strukturave ekzistuese. Konkretisht e kam fjalën për strukturat ekzistuese të menaxhimit të bregdetit, për ta zgjidhur një herë e mirë këtë mjegullnajë, e cila vjen ca nga padija, ca nga mungesa e përvojës dhe ca nga keqmenaxhimet e trashëguara në dekada. Kjo do të synojë që problematikat e shfaqura sa u takon elementeve të sigurisë dhe të pastërtisë, të adresohen më mirë, pasi jo rrallë njësitë e qeverisjes vendore përballen me mungesën e kapaciteteve financiare e njerëzore, duke mos përmbushur qëllimin për menaxhimin efikas të bregdetit. Pa dyshim, krijimi i këtyre strukturave tetë vjet më parë ishte një nismë e lavdërueshme dhe e domosdoshme, pasi ne trashëguam një situatë skandaloze. Në këta tetë vjet hovi cilësor është i dukshëm, me uljet e ngritjet e veta, për shkak se tashmë, tetë vjet më pas, vërehet domosdoshmëria e shkuarjes përpara dhe e rritjes së cilësisë për një menaxhim të qëndrueshëm të

zonës së bregdetit të orientuar drejt turizmit, si burim i rëndësishëm i zhvillimit të vendit dhe i ekonomisë së tij.

Ky ristrukturim është në çështjet e para të rendit të ditës. Vija bregdetare është atraksioni më i madh turistik. Prandaj do të ketë një vëmendje të posaçme, që përfshin bashkëpunimin shumë të ngushtë me bashkitë respektive; ndarjen e territorit në rajone monitorimi; krijimin e njësisë suplementare për sezonin e verës pranë strukturës që do të reformohet, sidomos planifikimin e stacioneve të plazhit që në 2 muajt e parë të vitit. Do të jetë detyrë e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit të koordinojë me bashkitë mirëmbajtjen, pastrimin dhe ofrimin e shërbimeve, sikurse do të koordinojë me ministrinë e tjera dhe me agjencitë në territor kujdesin shëndetësor, rendin publik, administrimin e mbetjeve dhe informacionin turistik. Është pak, por e sigurt, se puna për organizimin e sezonit të ardhshëm turistik në bregdet ka filluar. Faleminderit!